

## Z. Pedrazzi

Kam shumë besim se ky panel do të jetë mjaft sfidues duke pasur parasysh që të dyja palët, të interesuara në zhvillimet e mëtejshme, janë kryesisht në një lloj konflikti interesi. Në fakt, ne kemi përfaqësues të Punëdhënësve dhe të Kompanive për Menaxhimin e Aseteve, të cilët aktualisht ofrojnë Fonde Pensionesh. I pari mund të përballet me kosto shtesë, ndërkohë që ky i fundit do të rrisë të ardhurat e tij.

Në fakt, Sistemet e Pensioneve Vullnetare në Shqipëri janë dukshëm më pak të zhvilluara në krahasim me vendet fqinje dhe është e qartë, sidomos tani që kuadri ligjor është përmirësuar, se ekzistojnë hapësira dhe vullneti për të rritur depërtimin. Në këtë këndvështrim, duke marrë në konsideratë objektivat afatgjate, sipas mendimit tim personal, parashikoj që zgjidhja më efikase është prezantimi i një obligimi të detyrueshëm për të regjistruar të paktën të gjithë punëtorët e rinj në Fondet e Pensionit Vullnetar. Në fakt duket qartë që vetëm pak kompani, nga ato që kanë krijuar sisteme të brendshme, e konsiderojnë këtë instrument më tepër një “sistem nxitës” për punonjësit e tyre (shpesh duke pasqyruar skema tashmë të aplikuara në vendet e origjinës) sesa mënyrën më të mirë për të rregulluar një çështje sociale afatgjatë; gjithashtu ka mundësi që përfitimet që rrjedhin përfshijnë punonjës, të cilët tashmë kanë paga mbi mesataren.

Ky zhvillim reflekton atë që kemi vërejtur tashmë, në fazën fillestare, diku tjetër dhe kjo mund të konsiderohet një pikënisje e mirë; sidoqoftë, nuk është e mjaftueshme dhe ne duhet të kapim momentin e favorshëm për të nxitur zgjerimin dhe plotësuar boshllëkun me vendet e tjera.